

February 2017

PROFESIONI I KONTABILITETIT DHE AUDITIMIT –  
LUAJTJA E NJË ROLI POZITIV MBI TRAJTIMIN E  
KORRUPSIONIT

Draftet, Dokumentet e Konsultimit dhe botime të tjera të FNK janë të botuara nga FNK dhe të drejtat e autorit i posedon FNK.

FNK nuk pranon përgjegjësi për humbjen e shkaktuar ndaj çdo personi që vepron ose përmbahet nga veprimi duke u mbështetur në materialin në këtë botim, pavarësisht nëse humbja e tillë është shkaktuar nga neglizhenca ose ndryshe.

Logo e FNK, 'Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve' dhe 'FNK' janë marka tregtare dhe marka shërbimi të FNK.

Të drejtat e autorit © Tetor 2015 nga Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve (FNK). Të gjitha të drejtat e rezervuara.  
Kërkohet leja me shkrim nga FNK për të riprodhuar, ruajtur ose transmetuar, ose për të bërë përdorime të tjera të ngjashme të këtij dokumenti, përveç siç lejohet me ligj. Kontaktoni [permissions@ifac.org](mailto:permissions@ifac.org).

ISBN: 978-1-60815-326-8





"Profesioni i kontabilitetit dhe auditimit kërkon të krijojë një kornizë etike për të ndihmuar anëtarët e saj të flasin kur identifikojnë mashtrimin dhe korrupsionin."

- Rachel Grimes President i FNK

"Korrupsioni është një pengesë e rëndë për progresin e qëndrueshëm ekonomik, politik dhe shoqëror për vendet në të gjitha nivelet e zhvillimit... Kjo thekson rëndësinë e intensifikimit të përpjekjeve për të përmirësuar kornizat e qeverisjes dhe forcimin e veprimeve për të përmirësuar parandalimin, zbulimin dhe sanksionimin e korrupsionit. Çdo përpjekje për të luftuar korrupsionin kërkon një qasje gjithëpërfshirëse dhe të koordinuar."

- Korrupsioni drejtë fundit, Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim



Gjatë dy viteve të fundit, FNK ka angazhuar Qendrën e pavarur për Ekonomi dhe Hulumtime të Biznesit (Cebr) për të analizuar të dhënat tona të anëtarësisë dhe për të shqyrtuar rolin e profesionit të kontabilitetit dhe auditimit në shoqëri.

*Profesioni i Kontabilitetit dhe Auditimit - Luajtja e një Roli Pozitiv mbi Trajtimin e Korrupsionit* është raporti i tretë në këtë seri dhe ofron një përmbledhje të rolit të profesionit të kontabilitetit dhe auditimit në luftën globale kundër korrupsionit.

Raporti i parë, ***Seria 1: Profesioni i Kontabilitetit dhe Auditimit, Prapa Numrave***, thekson rëndësinë e kontabilistëve dhe auditorëve profesionistë për ekonomitë në rritje dhe krahason rritjen e profesionit me rritjen totale të punësimit brenda rajoneve. Pasqyrimi i përgjithshëm tregoi një profesion të kërkuar, duke u rritur në mënyrë të qëndrueshme dhe duke dhënë kontribute të konsiderueshme në të gjitha fushat e shoqërisë.

Raporti i dytë, ***Seria 2: Profesioni i Kontabilitetit dhe Auditimit - Shtim i Vlerës Globale***, ofron një pasqyrim të kontributit ekonomik të profesionit të kontabilitetit dhe auditimit në ekonominë globale dhe në shoqëri.

# PËRPARA

*Profesioni i Kontabilitetit dhe Auditimit - Luajtja e një Roli Pozitiv në Trajtimin e Korrupsionit* përmbledh hulumtimin në rolin thelbësor që luajnë kontabilistët dhe auditorët profesionistë, së bashku me akterët e tjerë kyç në ekonomi, për të trajtuar korrupsionin globalisht.

Korrupsioni është ndër çështjet më të dëmshme dhe urgjente me të cilat sot përballen qytetarët e botës. Ndër efektet e tij janë një ndikim thumbues në rritjen ekonomike që ndikon negativisht në përpjekjet për uljen e varfërisë dhe po ashtu në besimin e publikut në biznes, qeveri dhe shtetin e së drejtës.

Roli pozitiv i luajtur nga kontabilistët dhe auditorët në të gjithë botën në luftën kundër korrupsionit është i qartë dhe profesionalizmi theksohet si një përbërës thelbësor për suksesin. Kontabilistët dhe Auditorët profesionistë janë një grup në mes të një numri akterësh jetikë në ekonomi, duke përfshirë udhëheqësit e biznesit, qeveritë dhe sektorin financiar, të cilët janë kyç për të luftuar korrupsionin.

Një vendosmëri e shtuar dhe një punë e madhe konstruktive në luftën globale kundër korrupsionit ka qenë e dukshme në vitet e fundit dhe ky moment do të vazhdojë në 2017. Sidoqoftë, ky është një mision i pafund dhe problemi është i lashtë.

Për të arritur një sukses domethënës, është e domosdoshme që të ndodhin tre gjëra:

- përpjekjet bashkëpunuese në të gjithë sektorët - biznes, qeveri dhe profesione - duhet të intensifikohen për të miratuar standarde të qarta të qeverisjes organizative dhe mbrojtje të sinjalizimit për ata që dyshojnë ose identifikojnë veprime të gabuara;
- duke pasur parasysh shpenzimet e mëdha të sektorit publik, interesi global për menaxhim të fortë, transparent dhe të përgjegjshëm të financave publike duhet të ri-gjallërohet; dhe
- për të mbështetur interesin publik, duhet të ketë implementim më të madh global të standardeve ndërkombëtare me cilësi të lartë mbi raportimin financiar, auditimin dhe etikën.

Në luftën kundër korrupsionit, heshtja nuk duhet të jetë asnjëherë opsioni më i sigurt për çdo individ. Profesioni i kontabilitetit dhe auditimit, duke vepruar në interes të publikut, e ka mbështetur këtë luftë për dekada - dhe ne do të vazhdojmë ta bëjmë këtë.

## **Fayez Choudhury**

Kryeshef Ekzekutiv në FNK



## GJETJET KYÇE

### 1. Aty ku arkitektura e qeverisjes është më e fortë, roli i luajtur nga kontabilistët dhe auditorët profesionistë në luftimin e korrupsionit përforcohet.

Kontabilistët dhe Auditorët profesionistë janë një pjesë e arkitekturës qeverisëse që shërben për të luftuar korrupsionin dhe kontributi i tyre pozitiv përforcohet atje ku pjesa tjetër e asaj arkitekture është më e fuqishme. Lidhja në mes përhapjes së kontabilistëve dhe auditorëve profesionistë në fuqinë punëtore dhe rezultateve më të favorshme në masat kryesore globale të korrupsionit është më e fortë në vendet e G-20 dhe në vendet që kanë miratuar ligje kundër pastrimit të parave në përputhje me rekomandimet ndërkombëtare.

### 2. Kontabilistët dhe Auditorët profesionistë po luajnë një rol të madh, pozitiv në trajtimin e korrupsionit, së bashku me akterët e tjerë kyç në ekonominë globale.

Puna e kontabilistëve dhe auditorëve profesionistë është thelbësore për arkitekturën e qeverisjes së ekonomive, dhe së bashku me elementë të tjerë kyç shërbejnë për të mbështetur transparencën, llogaridhënien dhe shtetin e së drejtës. Ekziston një lidhje e fuqishme në mes përqindjes së kontabilistëve dhe auditorëve profesionistë në fuqinë punëtore dhe rezultateve më të favorshme për masat kryesore globale të korrupsionit.

### 3. Etika profesionale, edukimi dhe mbikëqyrja - në thelb të profesionit global të kontabilitetit dhe auditimit - janë thelbësore për rolin pozitiv të luajtur në trajtimin e korrupsionit.

Cilësitë kryesore që e bëjnë kontabilitetin dhe auditimin një profesion global janë kodi i saj etik i fuqishëm ndërkombëtar, kërkesat gjithëpërfshirëse arsimore dhe mekanizmat e mbikëqyrje së vazhdueshme. Lidhja me rezultatet më të favorshme të korrupsionit është tre herë më e fuqishme për kontabilistët dhe auditorët profesionistë që janë përkushtuar ndaj këtyre cilësive sesa për individët që mund të identifikohen si kontabilistë por nuk posedojnë kualifikime profesionale (për shembull, në vendet ku nuk kërkohen kualifikime profesionale, ose individë që punojnë në role mbështetëse).

## SFIDAT DHE MUNDËSITË

### Duke punuar së bashku për të forcuar qeverisjen dhe transparencën, dhe për të luftuar korrupsionin

Të gjithë lojtarët kyç në arkitekturën e qeverisjes së ekonomive tona, përfshirë profesionet, biznesin dhe qeverinë, si në sektorin privat ashtu edhe në atë publik, duhet të bashkëpunojnë për të implementuar standarde të qarta qeverisjeje për të gjitha organizatat.

#### Përmirësimi i kontabilitetit dhe auditimit në Qeveri

Menaxhimi i dobët financiar i Qeverisë, duke përfshirë më shumë paratë e gatshme sesa kontabilitetin e bazuar në akruale, mbetet një çështje e rëndësishme në shumë rajone dhe ka një ndikim negativ në vendimarrjen, llogaridhënien dhe transparencën. Miratimi i kontabilitetit të bazuar në akruale, dhe Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (SNKSP), nga të gjitha qeveritë dhe institucionet e sektorit publik është një prioritet urgjent.


#### Standarde të qëndrueshme ndërkombëtare

Për të mbështetur interesin publik, duhet të ketë adoptim më të madh global të standardeve ndërkombëtare me cilësi të lartë mbi raportimin financiar, auditimin dhe etikën. Kjo përfshin adoptimin dhe implementimin, në të gjitha juridiksionet, të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, Kodit të Etikës për Kontabilistët Profesionist<sup>™</sup>, lëshuar nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Etikës për Kontabilistët<sup>®</sup> (BNSEK<sup>®</sup>) dhe SNKSP. Këto standarde kanë një lidhje në integritet si në sektorin privat ashtu edhe në sektorin publik.

## LUAJTJA E NJË ROLI POZITIV

Kontabilistët dhe Auditorët profesionistë po luajnë një rol të madh pozitiv në trajtimin e korrupsionit, së bashku me akterët e tjerë kyç në ekonominë globale.

Korrelacioni i Indeksit të Përceptimit të Korrupsionit të Transparencës Ndërkombëtare me % kontabilistët dhe auditorët profesionistë në fuqinë punëtore.




Ekziston një korrelacion i fuqishëm në mes përqindjes së kontabilistëve dhe auditorëve profesionistë në fuqinë punëtore dhe një rezultat më të favorshëm në indeksin e perceptimit të korrupsionit të transparencës ndërkombëtare.<sup>1</sup>

<sup>1</sup>Proportioni i anëtarëve të organizatave anëtare të FNK në fuqinë punëtore përdoret për të përafëruar përqindjen e kontabilistëve dhe auditorëve profesionistë në ekonomi.


## ARKITEKTURË MË E FORTË QEVERISËSE

Aty ku arkitektura e qeverisjes është më e fortë, roli i luajtur nga kontabilistët dhe auditorët në luftimin e korrupsionit përforcohet.

G-20 Korrelacioni i Indeksit të Perceptimit të Korrupsionit me Transparencën Ndërkombëtare të Vendet me % e kontabilistëve dhe auditorëve profesionistë në fuqinë punëtore



Vendi i Task Forcës së Veprimit Financiar me Korrelacionin e Indeksit të Perceptimit të Korrupsionit me Transparencën Ndërkombëtare me % e kontabilistëve dhe auditorëve profesionistë në fuqinë punëtore



Korrelacioni është deri në tre herë më i fortë si në vendet e G-20 ashtu edhe në vendet që kanë miratuar rekomandimet e Task Forcës së Veprimit Financiar, pastrimin e parave ndërkombëtare dhe luftimin e financimit të terrorizmit dhe standardeve të përhapjes.




## THELBI GLOBAL I PROFESIONIT TË KONTABILITETIT DHE AUDITIMIT

**Etika profesionale, edukimi dhe mbikëqyrja - në thelb të profesionit global të kontabilitetit dhe auditimit- janë thelbësore për rolin pozitiv të luajtur në trajtimin e korrupsionit.**

Proporcioni i kontabilistëve dhe auditorëve profesionistë në ekonomi - ata që janë pajtuar me kërkesa të forta etike, arsimore dhe mbikëqyrëse - është tre herë më i lidhur me rezultate më të favorshme për masat ndërkombëtare të korrupsionit, sesa për individët që identifikohen si kontabilistë, por që mund të mos kenë kualifikimet profesionale.

Bazuar në statistikat e tregut të punës, Cebr vlerëson se organizatat anëtare të FNK përfaqësojnë një të tretën (pothuajse 3 milion njerëz) të ekologjisë globale të kontabilitetit dhe auditimit me dy të tretat e mbetura të identifikuara nga statistikat e punës si kontabilistë dhe auditorë, ose që punojnë në një fushë të ngjashme (referoju Serisë 2 për më shumë detaje). Këta janë individë që mund të punojnë në një vend që nuk kërkon kualifikim profesional të kontabilitetit, ose që punojnë në një funksion mbështetës të kontabilitetit.

**Fuqia krahasuese e korrelacionit me Indeks të favorshëm të Perceptimit të Korrupsionit të Transparencës Ndërkombëtare**



**Çfarë do të thotë profesionalizëm në profesionin global të kontabilitetit dhe auditimit?** Organizatat anëtare të FNK janë organizata profesionale të kontabilitetit dhe auditimit që janë të përkushtuara në:

- Sigurimin e Cilësisë
- Standardet Ndërkombëtare të Edukimit për kontabilistët profesionistë
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe standardet përkatëse
- *Kodi i Etikës për Kontabilistët dhe Auditorët Profesionistë*
- Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
- Hetimi dhe disiplina
- Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar



Ekziston gjithashtu një korrelacion i fuqishëm ( $R^2 = 49\%$ ) në mes të adoptimit të kërkesave etike, arsimore dhe hetimit dhe disiplinës të profesionit global të kontabilitetit dhe auditimit dhe rezultateve më të favorshme në masat ndërkombëtare të korrupsionit.

## TË PËRKUSHTUAR NË ZVOGËLIMIN E KORRUPSIONIT

**Profesioni global i kontabilitetit dhe auditimit është i përkushtuar në rolin e tij në trajtimin e korrupsionit.**

### **Profesionet bashkëpunojnë për të luftuar korrupsionin**

Përpara Samitit Anti-Korrupsion në Londër 2016, FNK nënshkroi një deklaratë të përbashkët ku dënon korrupsionin së bashku me organizatat profesionale të kontabilitetit dhe auditimit dhe zyrën ligjore në Mbretërinë e Bashkuar.

*Mito dhe korrupsioni përfaqësojnë kërcënime serioze për rritjen ekonomike, jetesën individuale dhe shoqërinë civile në të gjithë botën.*

*Për shumë vite, organet profesionale kanë punuar së bashku me qeverinë, rregullatorët, zbatimin e ligjit dhe organet ndërkombëtare dhe kanë mbështetur anëtarët tanë për të luftuar miton, korrupsionin, evazionin tatimor, pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit ndërkombëtar. Ne do të vazhdojmë këtë punë dhe do të sigurojmë mbështetje për të lehtësuar bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar dhe për të përmirësuar sistemet e monitorimit dhe zbatimit.*

*Ne shprehim keqardhje për korrupsionin dhe dëmin e konsiderueshëm që ai shkakton; ne luajmë një rol jetësor në trajnimin, edukimin dhe mbështetjen e profesioneve tona për të mbështetur nivelet më të larta të integritetit dhe standardeve etike.*

*Ne e dimë që kriminelët kërkojnë të abuzojnë me shërbimet e ofruara nga anëtarët tanë për të pastruar të ardhurat e korrupsionit dhe ne jemi të përkushtuar për të siguruar që profesionet të cilave u shërbejmë janë të armatosura me mjete për të penguar këtë abuzim.*

*Ne qëndrojmë të bashkuar në luftën kundër korrupsionit në të gjitha format e tij dhe jemi të përkushtuar për ndarjen e njohurive, aftësive dhe inteligjencës me kolegët tanë profesionistë dhe me të gjitha agjencitë që luftojnë këtë kauzë.*

### **Mbështetja e Komunitetit Ndërkombëtar**

Në takimin ministror të OECD-së kundër Mito në Mars 2016, atëherë Presidentja e FNK Olivia Kirtley theksoi një botë gjithnjë e më komplekse dhe të ndërlikuar që kërkon bashkëpunim dhe angazhim të fortë nga komunitetet private, publike dhe rregullatore për të luftuar miton dhe korrupsionin.

Profesioni global i kontabilitetit dhe auditimit e ka përqendruar thirrjen e tij për veprim për Samitin e Liderëve G-20 2016 mbi besimin dhe integritetin, duke nxitur hapa drejt qeverisjes më të fortë në biznes dhe sektorin publik dhe një mjedis rregullator bashkëpunues, të qëndrueshëm global.



## TË PËRKUSHTUAR NË ZVOGËLIMIN E KORRUPSIONIT

### Llogaridhënia. Tani.

Llogaridhënia. Tani. është një fushatë për standarde më të larta të informacionit të sektorit publik në të gjithë botën. Roli i tij është të sigurojë një katalizator për ndryshimin. Ajo i sfidon qeveritë të njohin rëndësinë e punës për raportimin financiar që plotëson standardet ndërkombëtare.

Fushata përfshin iniciativat e mëposhtme:

- Ndërtimi i një koalicioni global duke sjellë së bashku organizata që mbështesin përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies në sektorin publik.
- Rritja e ndërgjegjësimit duke përforcuar përfitimet e raportimit të shëndoshë financiar të qeverive të pabindura për nevojën e ndryshimit.
- Zhvillimi i partneriteteve për të ndikuar në ndryshime duke bashkuar akterët relevant në komunitetin e sektorit publik për të ndërmarrë veprime për të përmirësuar informacionin financiar në sektorin publik.
- Ndërtimi i kapaciteteve në nivel vendi përmes angazhimit me organizatat lokale të kontabilitetit dhe auditimit, duke ndihmuar në zhvillimin e një linje të kontabilistëve dhe auditorëve profesionistë të trajnuar mirë për të punuar me organizatat qeveritare në mënyrë që të sjellë ndryshimin që kërkohet.

### Thirrja e dialogut ndërkombëtar drejt rregullimit më efektiv dhe rivendosja e besimit në biznes dhe qeveri

Gjatë 2015 dhe 2016, FNK organizoi dy tryeza të rrumbullakëta të përqendruara në promovimin e rregullimit global të qëndrueshëm, me cilësi të lartë, për të ndihmuar rritjen ekonomike globale dhe për të luftuar në mënyrë më efektive problemet globale, të tilla si korrupsioni. Diskutimet përfshinin drejtues të lartë dhe ekspertë nga agjencitë rregullatore, tregjet financiare, qeveria, academia, kompanitë e listuara, fondet e investimeve dhe profesioni i kontabilitetit dhe auditimit.



Më shumë se 60 ekspertë u mblodhën për të promovuar rregullore globale të qëndrueshme, me cilësi të lartë, për të ndihmuar rritjen ekonomike globale dhe për të luftuar në mënyrë më efektive problemet globale, të tilla si korrupsioni, gjatë tryezës në Londër në korrik 2016.

### Fuqizimi i Kodit të Etikës për Kontabilistët dhe Auditorët Profesionistë

Në korrik 2016, një standard i ri u lëshua nga IESBA që përcakton një kornizë për të drejtuar kontabilistët dhe auditorët profesionistë në ato veprime për të marrë në interes të publikut kur ata bëhen të vetëdijshëm për një veprim të paligjshëm të mundshëm, të njohur si jo-pajtueshmëria me ligjet dhe rregulloret, ose NOCLAR, kryer nga një klient ose punëdhënësi.







*Fuqizimi i Organizatave, Përparimi i Ekonomive*



International Federation of Accountants  
529 Fifth Avenue  
New York, NY 10017  
USA  
T +1 212 286 9344  
[www.ifac.org](http://www.ifac.org)